



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.48, datë 23.02.2023

PËR  
“VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKUROREN  
SUELA BELULI, KANDIDATE PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË  
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË FIER”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159, pika 1 dhe 2 germa “a”, 184 dhe 189 pika 1, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 48 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 9 pika 5 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” Kreun VI, Seksionin Ç, pika 8, germa “ç”, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me relacionin “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokuroren Suela Beluli, candidate për pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokuroren Suela Beluli, candidate për pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidates prokurore Suela Beluli të vijojë me procedurën e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
3. Të njoftohet për këtë vendim zonja Suela Beluli.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 23.02.2023.



KRYETAR  
Alfred Balla

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Nurhan Seiti

ANËTAR  
Eloida Goxhi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Mirela Bogdani

ANËTAR  
Arta Mandro

ANËTAR  
Ledina Riza